

Performanca e Buxhetit 2018



NË KËTË RAPORT

Periudha raportimit: Janar - Dhjetor 2018

Statusi raportit: Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Rrogozhinë gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Rrogozhinë me asistencën e Projektit "Bashki të Forta". Për më shumë informacion në lidhje me të kontaktoni me Z.Fatmir Murati në adresën fatmirmurati66@gmail.com

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Popullsia: Censuri (2011) 22.148 banorë
 Rregjistri Civil 40.684 banorë
 Sipërfaqja: 223.5 km²
 Dendësia: Censuri (2011) 99 banorë/km²
 Rregjistri Civil 182 banorë/km²

Nëndarjet Administrative: 5

(1) Rrogozhinë (2) Kryevidh (3) Sinaballaj (4) Lekaj
 (5) Gosë

Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



Shpërndarja e anëtarëve:

5	Anëtarë
5	Anëtarë
4	Anëtarë
2	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë

EKZEKUTIVI Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Rrogozhinë për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 30.348 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 42.45%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PD, LSI, PR.

Kryetari i Bashkisë është **Z. Beqir NUREDINI**.

departamentet e Bashkisë përfshijnë: finance dhe buxhet, tatim taksa vendore, politikat e zhvillimit, shërbimet publike, bujqësia dhe pyjet, shërbimet sociale, planifikim dhe kontrolli i teritorrit, policia bashkiake, mbrojtja e teritorit, ligjore, administratë dhe burimet njerëzore, arsim dhe edukim;

EKONOMIA Bashkia e re e Rrogozhinës shtrihet në një terren pjesërisht kodrinor dhe pjesërisht fushor deri në bregun e detit. Bashkia e re do të ketë për qendër qytetin e Rrogozhinës, i cili u krijua në kohën e komunizmit përreth agroindustrialit, si fabrika e vajit dhe sapunit apo ajo e zhveshjes së pambukut, si dhe një linjë për përpunimin dhe konservimin e ushqimeve. Qyteti i Rrogozhinës zë rreth një të tretën e të gjithë popullsisë banuese të bashkisë së re.

Dy komunat bregdetare, Gosa dhe Kryevidhi, kanë mundësi të zhvillojnë turizmin. Bashkia e re do të përfshijë edhe zona të rëndësishme bujqësore.

SITUATA FINANCIARE

Objektivat e bashkisë Rrogozhinë:


- ⇒ Përmirësimi i grumbullimit të të ardhurave vendore;
- ⇒ Rritja e kapaciteteve dhe mjeteve shtrënguese në zbatim të ligjit;
- ⇒ Ndyshimi i strategjisë së Zhvillimit Bujqësor në rritjen e shpenzimeve direkte në përmirësimin e treguesve të tokave bujqësore;
- ⇒ Rritja e kapaciteteve turistike detare dhe rurale në promovimin e kulturave vendase, kulinari dhe rritje të atraksioneve tërheqëse panoramike;
- ⇒ Rritja e kapaciteteve menaxhuese të mbetjeve Urbane dhe gjetje e metodave të përshtatshme të riciklimit.

Fakt 2016, 2017, 2018



Burimi i informacionit
*FPC 2018 - Ministria e Financave

2018 Vs 2017




Burimi i informacionit
*FPC 2018 - Ministria e Financave

SHËRBIMET DHE TË ARDHURAT 2018

Burimet e financimit planifikim 2018


- ⇒ Transferta e pakushtëzuar (granti);
- ⇒ Transferta specifike;
- ⇒ Të ardhurat nga burimet e veta;
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017;
- ⇒ Transferrat e kushtëzuara ;




Shërbimet kryesore të ofruara dhe financuara nga bashkia janë

- | | |
|---|---|
| ⇒ Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimit | ⇒ zhvillimit |
| ⇒ Çështjet financiare dhe fiskale | ⇒ Furnizimi me ujë të pishëm |
| ⇒ Shërbimet publike të përgjithshme | ⇒ Ndriçimi i rrugëve |
| ⇒ Planifikimi i territorit | ⇒ Sporti dhe muzeumet |
| ⇒ Shërbimet e policisë vendore | ⇒ Trashëgimia kulturore, monumentet dhe muzetë, bibliotekat |
| ⇒ Kadastra | ⇒ Mëshuesit e kopshteve dhe pagat e stafit mbështetës |
| ⇒ Këshillimi bujqësor | ⇒ Pagat e stafit mbështetës |
| ⇒ Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve | ⇒ Programe arsimore për trajnimin e mësuesve |
| ⇒ Shërbimet sanitare | ⇒ Kujdesi social për të sëmurë dhe PAK |
| ⇒ Programet e mbrojtjes së mjedisit | ⇒ Strehimi social |
| ⇒ Administrimi i burimeve ujore | ⇒ Ndihma ekonomike |
| ⇒ Ndërtimi dhe menaxhimi i banesave sociale | |
| ⇒ Programet e | |

TË ARDHURAT 2018



Burimi: Bashkia Rrogzhinë, FPT 2019-2020



Burimi: Bashkia Rrogzhinë, FPT 2019-2020


SHPENZIMET

Bashkia Rrogozhinë i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë në rritje shërbimeve sociale dhe infrastrukturës.

Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbëjnë rreth 88% të buxhetit janë:


- A. Planifikim, Menaxhim, Administrim
- B. Kujdesi Social
- C. Strehimi dhe zhvillimi i komunitetit
- D. Arsimin (parashkollor dhe atë parauniversitar
- E. Uji dhe kanalizime

% në buxhet



Programi me peshën më të madhe në buxhetin e bashkisë Rrogozhinë është Administrata, kurse "Shërbime publike" ka peshën më të ulët

Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore në Leke




Bugeti Informativ
"Raport Mbrojtësor 2018 - Bashkia Rrogozhinë"

SHPENZIMET

Në grafik paraqitet përqindja e realizimit ndaj planifikimit, ndërsa tabela më poshtë liston investimet më të rëndësishme të bashkisë.

Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik në Lekë



Burimi i Informacionit
"Raporti i Monitorimit të BE - Shërbimi Rregullor"

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë nëpërmjet treguesve të performancës sipas programeve.

PROGRAMI

UJI I PIJSHËM DHE KANALIZIMET


Objektiva

*Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ujit të pijshëm
Përmirësimi i menaxhimit të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha) / shërbimeve sanitare*


TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP1.** Popullsia e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm dhe kanalizime në %
- ◆ **TP2.** Norma e arkëtimit të tarifave në %
- ◆ **TP3.** Norma e mbulimit të kostove të shërbimit nga të ardhurat e realizuara nga tarifa e shërbimit në %
- ◆ **TP4.** Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm në 24 orë

Performanca e shërbimit ujë i pijshëm dhe kanalizime 2016-2018



Kohëzgjatja e u furnizimit me ujë të pijshëm (orë në ditë)



**Realizimi i shpenzimeve:
(54.424 mijë lekë, 8% e
buxhetit)**

PROGRAMI

MENAXHIMI I MBETJEVE

Objektiva

Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane


Realizimi i shpenzimeve: (47.700 mijë lekë, 7% e buxhetit)




TREGUES PERFORMANCE

- ♦ **TP1.** % e popullatës e mbuluar me shërbim
- ♦ **TP 2.** % e sipërfaqes së territorit e mbuluar me shërbim
- ♦ **TP 3.** % koston së shërbimit e mbuluar nga tarifa

tregues performance 2018



Kosto e menaxhimit të një ton mbetje në Lekë



PROGRAMI

ARSIMI PARASHKOLLOR

Objektiva

- ⇒ Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve për arsimin
- ⇒ Rritja e cilësisë së jetës kulturore e sportive të bashkisë.
- ⇒ Rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes ngritjes/rehabilitimit të infrastrukturës arsimore rishpërndarja më optimale e numrit të nxënësve në shkollat e qytetit të Rrogozhinës

Realizimi i shpenzimeve : 58.680 mijë lekë, 8% e buxhetit

TREGUES PERFORMANCE

- ♦ **TP1.** Numri i fëmijëve të regjistruar që ndjekin kopështin (grup-mosha 3-6 vjeç)
- ♦ **TP2.** Numri mesatar i fëmijëve për mësues /edukator në para-shkollë
- ♦ **TP3.** Kapaciteti maksimal i akomodimit Numri i shtretërve (-Kopështe dhe Çerdhe)
- ♦ **TP4.** Numri i ndërtesave funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë
- ♦ **TP5.** Shpenzimeve operative për mirëmbajtjen dhe investimet në institucionin e arsimit parashkollor dhe atij bazë



PROGRAMI

STREHIMI DHE ZHVILLIMI I KOMUNITETIT

Objektiva

⇒ Bashkia siguron strehim social për kategoritë në nevojë

TREGUES PERFORMANCE

- ♦ **TP 1.** Numri personave të mbështetur me strehim social
- ♦ **TP 2.** Rritja e të ardhurave nga shërbimi i banesave sociale të bashkisë ('Të ardhurat nga qeraja e banesave sociale në %)



⇒ Realizimi i shpenzimeve : 126.735 mijë lekë, 18% e buxhetit

PROGRAMI

KUJDESI SOCIAL—SËMUNDJE PAAFTËSI DHE NE

TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP1.** Shërbime sociale për moshat e treta (në % kundrejt planit)
- ◆ **TP2.** Shërbime sociale për fëmijët në nevojë (në % kundrejt planit)
- ◆ **TP3.** Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë (në % kundrejt planit)

Objektiva

- ⇒ Mbështetja financiare e shtresave në nevojë përmes përfshirjes së tyre në projekte për NE dhe PAK.
- ⇒ Nxitja e punësimit të rinjve, vajza dhe djem përmes trajnimeve profesionale në fusha të ndryshme.

Realizimi i shpenzimeve : (131.144 mijë lekë 18% e buxhetit)

